

STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“Zurich Investment Group” Sh.p.k.

Sot më datë 18.06.2021, Z. Alban Efthimi, shtetas shqiptar, lindur më date 13.10.1970 në Tiranë dhe banues në Tiranë me mjet identifikimi Karte Identiteti me nr. personal H01013093A, në cilësinë e ortakut themelues ka vendosur të nënshkruajë Statutin e mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe nga ky Statut.

NENI 1
EMËRTIMI

- 1.1 Emërtimi i shoqërisë është **“Zurich Investment Group” Sh.p.k.** më poshtë e quajtur **“Shoqëria”**.
- 1.2 Shoqëria themelohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar sipas legjislacionit shqiptar.

NENI 2
SELIA

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në Tiranë, Shqipëri, në adresën: Rruga e Kosovarëve, Pallati **“Dolçka”**, Apartamenti ½, Njësia Administrative nr. 5, Tiranë.

NENI 3
KOHËZGJATJA

- 3.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë me afat të papërcaktuar.

NENI 4
OBJEKTI I SHOQËRISË

- 4.1 Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen dhe marrjen pjesë në të gjitha aktivitetet që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, dhe në veçanti:
 - a. Investime me pjesëmarrje në kuota;
 - b. Ofrimi i shërbimit të konsulencës, në fushën e biznesit, menaxhimit, taksave, informatikës etj;
 - c. Menaxhimi i qendrave tregtare, bareve dhe restoranteve;
 - d. Importi-eksporti, shitja me shumicë dhe pakice e pajisjeve elektrike, teknologjike, lëndë të para për industrinë, materiale ndërtimi dhe hidrosanitare, pajisje zyresh kancelari, pjesë këmbimi, auto dhe makineri të cdo lloji, pajisje teknologjike etj;
 - e. Shitja, blerja, dhënia me qira e pasurive të paluajtshme;
 - f. Transporti i malirave dhe udhëtarëve brenda dhe jashtë vendit;
 - g. cdo veprimtari tjetër ekonomike që do të konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme për realizimin e qëllimit të Shoqërisë e që nuk bie ndesh me legjislacionin Shqiptar në fuqi.

NENI 5
KAPITALI THEMELTAR

- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100 Lekë (njëqind). Kapitali themeltar është nënshkruar tërësisht nga ortakut i vetëm themelues, Z. Alban Efthimi, i cili është zotëruar në një kuotë që përfaqëson 100% të kapitalit themeltar, e barabartë me 100 Lekë (njëqind);
- 5.2 Përgjegjësia e ortakut ndaj të tretëve, për detyrimet e Shoqërisë, kufizohet në masën e pjesëmarrjes së tij në kapitalin themeltar.



- 5.3 Në rast se ne te ardhmen kapitali themeltar i shoqerise, si pasoje e cedimit te pjeshem te kuotes nga Ortaku i vetem, do te posedohet nga 2 ose me shume ortake, asnjë nga ortaket nuk mund të transferojë kuotat përkatëse të pjesëmarrjes në Shoqëri pa miratimin paraprak me shkrim së ortakëve të tjerë.
- 5.4 Pavarësisht nga parashikimet e paragrafit 5.3, secili ortak mund të shesë lirisht, të gjithë ose pjesë, kuotën e tij një ortaku tjetër.
- 5.5 Gjithsesi, ne rast se kapitali i shoqerise ne te ardhmen do te posedohet nga nje ortak tjetër i vetem, ose nga 2 apo me shume ortake, asambleja e ortakeve mund te vendose te ndryshoje kete statut dhe te parcaktoje rregulla te reja ne lidhje me te drejtat dhe menytrat e cedimit te metejshem te kuotave mes ortakeve ose dhe ndaj te treteve.

NENI 6 NDRYSHIMET E KAPITALIT

- 6.1 Asambleja e Përgjithshme mund të zmadhojë kapitalin e Shoqërisë, me kuorumin e përcaktuar në pikën 7.5 të këtij Statuti. Vendimi i Asamblesë se Përgjithshme për zmadhimin e kapitalit do ti komunikohet me shkrim ortakëve të cilët u thirren por nuk ishin të pranishëm në mbledhjen e Asamblesë se Përgjithshme që vendosi për zmadhimin e kapitalit.
- 6.2 Në rast zmadhimi të kapitalit, të gjithë ortakët do të kenë të drejtë të nënshkruajnë zmadhimin e kapitalit, në para ose me kontribute në natyrë, në përpjesëtim të drejtë me kuotat që zotërojnë në Shoqëri.
- 6.3 Në rast se disa ortakë heqin dorë nga e drejta e nënshkrimit, kapitali që nuk është nënshkruar mund të nënshkruhet nga ortakët e tjerë. Në këtë rast, këta ortakë mund të ushtrojnë të drejtën për nënshkrimin e kapitalit, në përpjesëtim të drejtë me kuotat e pjesëmarrjes në Shoqëri.
- 6.4 Asambleja e Përgjithshme mund të zvogëlojë kapitalin e Shoqërisë, me kuorumin e përcaktuar në nenin 7.5 të këtij Statuti. Në çdo rast kapitali i Shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën kufirin e përcaktuar me ligj.
- 6.5 Ortakët e përballojnë zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, në përpjesëtim të drejtë me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e Shoqërisë.

NENI 7 ASAMBLEJA E ORTAKEVE

- 7.1 Asambleja e Ortakëve, e thirrur në pajtim me ligjin dhe rregullisht e mbledhur, përfaqëson të gjithë ortakët dhe është organi vendimmarrës i Shoqërisë. Vendimet e Asamblesë së Ortakëve, të marra në përputhje me ligjin dhe statutin detyrojnë të gjithë ortakët rregullisht të mbledhur, që kanë marrë pjesë apo kanë votuar kundër.
- 7.2 Asambleja e Ortakëve duhet të mbledhet të paktën një herë në vit brenda gjashtë muajve nga përfundimi i vitit financiar.
- 7.3 Çdo ortak mund të përfaqësohet nga një ortak tjetër ose nga një përfaqësues i deleguar.
- 7.4 Asambleja e Ortakëve në marrjen e vendimeve që kërkojnë shumicë të zakonshme mbledhet nga ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë me shumicë se 51 për qind të kapitalit dhe vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.
- 7.5 Asambleja e Ortakëve në marrjen e vendimeve që kërkojnë shumicë të kualifikuar vendos me votën pro, të jo më pak se $\frac{3}{4}$ të votave që përfaqësojnë kapitalin total të shoqërisë.



NENI 8
ADMINISTRIMI I SHOQËRISË


- 8.1 Shoqëria administrohet nga Administratori, i cili ka kompetencat e përfaqësimit të Shoqërisë dhe kompetencat për të kryer të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm të Shoqërisë, në përputhje me ligjin nr. 9901, "Per tregtaret dhe shoqërite tregtare" i ndryshuar, dhe statutin e Shoqërisë.
- 8.2 Administratori përfaqëson Shoqërinë ndaj të gjithë personave fizike e juridikë, vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore shqiptare apo të huaja. Administratori kryen të gjitha aktet që i konsideron të nevojshme për realizimin e objektit të Shoqërisë, përveç akteve që sipas ligjit apo statutit janë në kompetencë të Asamblesë së Ortakëve apo organeve të tjera të Shoqërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe statutin e Shoqërisë, si dhe vendos edhe mbi çështjet e mëposhtme:
- 8.3 Blerjen e pasurive të paluajtshme të barabartë dhe nën 5 (pese) milion euro;
- 8.4 Miratimin e kërkesave të reja për financim nga institucionet financiare dhe rivonimin e tyre ekzistuese;
- 8.5 Vendosjen e barreve apo kufizimeve mbi pasuritë e luajtshme dhe/ose të paluajtshme të Shoqërisë në favor të të tretëve.
- 8.6 Administratori emërohet për një periudhë 5 (pese) vjeçare. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera në administrimin e Shoqërisë.
- 8.7 Administratori i vetëm i Shoqërisë emërohet Z. Alban Efthimi.

NENI 9
REGJISTRI I VENDIMEVE

- 9.1 Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme duhet të regjistrohen në Regjistrin e Vendimeve, të dhenat e të cilit nuk mund të ndryshohen. Regjistri i Vendimeve duhet të mbahet nga Administratori, dhe çdo regjistrim duhet nënshkruar nga Administratori.

NENI 10
KONTROLLI FINANCIAR, BILANCI, DIVIDENDET

- 10.1 Kontrolli financiar i shoqërisë do të kryhet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Asambleja e Ortakëve do të emërojë një apo më shumë ekspertë kontabël në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose i detyrueshëm sipas ligjit shqiptar.
- 10.2 Mbajtja e librave të Shoqërisë dhe e dokumentacionit kontabël të Shoqërisë do të kryhet në përputhje me statutin e Shoqërisë dhe me parashikimet e legjislacionit shqiptar në fushën e të drejtës civile dhe tatimore.
- 10.3 Viti Financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor.
- 10.4 Me mbylljen e secilit vit financiar, Administratori kryen të gjithë veprimet e nevojshme për përgatitjen e bilancit vjetor dhe të dokumenteve kontabile që do të miratohen nga Asambleja e Ortakëve. Asambleja e Ortakëve miraton bilancet vjetore ose i kërkon Administratorit, në përputhje me afatet ligjore, të kryejë ndryshimet e nevojshme.
- 10.5 Asambleja e Ortakëve vendos në lidhje me shpërndarjen e fitimit neto (dividend) që rezultojnë nga bilanci i miratuar. Shuma e fitimit neto që do të shpërndahet do të përcaktohet në bazë të bilancit vjetor, pasi të jenë zbritur humbjet e mundshme.



NENI 11
LIKUIDIMI I SHOQËRISË


- 11.1 Procedura e likuidimit e parashikuar ne ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" do të zbatohet edhe ne rastin e prishjes se Shoqërisë.
- 11.2 Ne rast se Asambleja e Përgjithshme vendos per prishjen e Shoqërisë, do të emërohen një ose me shumë likuidues.
- 11.3 Eksperti kontabël i Shoqërisë do të emërohet nga Asambleja e Përgjithshme nëse emërimi i tij është i detyrueshem në bazë të legjislacionit në fuqi. Mandati i Ekspertit kontabel është i rinovueshëm me vendim të Asamblesë se Pergjithshme.

NENI 12
TE NDRYSHME

- 12.1 Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e saj tregtar në përputhje me këtë Statut dhe me legjislacionin shqiptar. Ligji shqiptar "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar do të rregullojë rastet që nuk parashikohen në këtë statut.
- 12.2 Mosmarrëveshjet qe mund të lindin ndërmjet Shoqërisë dhe ortakëve, apo ndërmjet ortakëve dhe trashëgimtarëve të ortakëve ose ortakëve te tjerë dhe/ose Shoqërisë, qe kane për objekt te drejta te lidhura me Shoqërinë, do te zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.

ORTAKU I VETEM THEMELUESME VULLNET TE LIRE E TE PLOTE E NËNSHKRUAN KETE STATUT TE SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TE KUFIZUAR "Zurich Investment Group" SHPK

Alban Efthimi



ORTAKU I VETEM THEMELUES

